



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-8927/20
Kaçanik, 26.03.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I –r (Parë) e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, mbajtur me 26 Mars 2020.

Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale në sallën e KK në ora 10:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi ishin 26 anëtarë, ndërkaq në mbledhje mungoj me arsye anëtarja, Aferdita Shehi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtoret e drejtorive komunale: Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Fatmir Loku, Diana Reka. Pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin edhe: Komandanti i policisë- Halim Shehu, Kryetari i BI të Kaçanikut-Fidaim Fazliu, drejtori i QKMF- Sinan Zeneli.

Mbledhjen e udhëhoqi Kemal Mërseli, Kryesues i KK,
Procesmbajtës, Maklfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Merseli përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi, dha një Rezime të shkurtër për arsyet e thirrjes së kësaj mbledhje. Kërkesa ka ardhur nga Shtabi i Emergjencës dhe Kryetari i Komunës për shkak se nevojiten mjete buxhetore për me qenë në gjendje gatishmërie për menaxhimin e situatës lidhur me pandeminë COVID 19. Kësaj mbledhje i ka paraprirë një mbledhje me Ekzekutivin e Komunës dhe me shefat GP të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.

Meqë Qarkorja e cila na ka ardhur nga MAPL pezullon të gjitha mbledhjet e KK dhe pezullimin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave, mirëpo kjo mbledhje do të mbahet për shkak të nevojës për mjetet buxhetore për menaxhimin e situatës. MAPL është pajtuar që vendime të kësaj natyre të dërgohen në MAPL dhe në MEF për shqyrtimin e tyre të ligjshmërisë.

Për shkak të virusit Covid-19- komuna ka marrë veprime të nevojshme për krijimin e kushteve të mbajtjes së mbledhjes, duke bërë dezinfektimin e sallës së KK, pajisjen e anëtarëve të KK me dorëza e maska, dezinfektues të duarve etj.

Prezent në mbledhje janë përfaqësues nga Shtabi Emergjent, Komandanti i policisë, drejtori i QKMF, Kryetari i BI të Komunës së Kaçanikut, të cilët do të raportojnë secili nga pozicioni i vet për veprimet të cilat i kanë marrë, dhe për t'na njoftuar si është gjendja deri me tani lidhur me situatën e pandemisë Covid-19. Fillimisht e ka fjalën Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Paraqiti situatën lidhur me COVID-19 dhe veprimet të cilat janë marrë. Fillimisht e kemi formuar Shtabin e Emergjencës për me u marrë me menaxhimin e situatës, ndërkaq kemi menduar që ky shtab të plotësohet edhe me 3 anëtarë nga KK. Veprimet të cilat janë marrë si komunë; Nxënësit janë liruar nga mësimi në bazë të vendimeve të MASHT, ndërkaq duhet me qenë gjendje gatishmërie, edhe pse deri me tani në komunën tonë nuk ka ndonjë rast të virusit të paraqitur.

Për mungesën e mjeteve buxhetore, Shkresë i kemi dërguar Zyrës së Kryeministrit Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkaq deri me tani nuk kemi marrë ndonjë përgjigje. Kemi pasur edhe donacione nga: “Viva Fresh” na ka ndihmuar me 150 pako ushqimore, Kemi një iniciativë edhe nga ETC për 200 pako ushqimore. Një ndihmë tjetër është edhe nga BI - xhamia e Dubravës, edhe pse nuk po donë me i bërë publike këto donacione.

Nesër kemi takim me administratoret e fshatrave, ku në atë takim ku do të shqyrtojmë nevojat e familjeve nëpër komunitete. Pardje na ka ardhur një Qarkore nga MAPL lidhur me pezullimin e aktiviteteve të KK dhe ligjshmërinë e vendimeve me përjashtim të vendimeve për çështje financiare.

Kryesuesi i Kuvendit, Fjalën e ka komandanti i policisë - njësia në Kacanik, Halim Shehu.

Komandanti i policisë- Halim Shehu, Pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi, paraqiti gjendjen në Komunën e Kaçanikut të qetë. Si komunë gjendja është e qetë, deri me tani nuk kemi ndonjë rast me koronavirus. Një grua me një fëmijë kanë ardhur nga jashtë dhe të njëjtit janë në karantinë. Sa i përket gjendjes emergjente, nuk është duke u respektuar sa duhet sidomos pas orës 16:00, sepse qytetarët po dalin me të madhe për nevojat e tyre dhe kjo gjendje na krijon frikë për mundësi të përhapjes së koronavirus. Jemi në bashkëpunim me Shtabin e emergjencës dhe organet tjera relevante për menaxhimin e situatës. Sa i përket shpërndarjes së pakove ushqimore dhe gjerave të tjera të nevojshme, ne mund t’iu ndihmojmë në këtë proces me automjete kurdo që është e nevojshme, së paku mundemi të asistojmë në këtë proces.

z. Sinan Zeneli- Drejtor i QKMF, Situata në komunën tonë është nën kontroll, kemi pasur disa raste të dyshimta për koronavirus dhe të njëjtit i kemi dërguar në Prishtinë, por nuk kanë rezultuar me koronavirus. Është bërë dezinfektimi i objekteve shëndetësore, ekipet tona janë të angazhuara në bashkëpunim me komunën për menaxhimin e situatës. Masa kryesore janë; të respektojmë rregullat e IKSHF nga të gjithë, ndërkaq e falënderoj donacionit që na kanë ardhur, qoftë me mjete apo në formë të tjera nga kushdo qoftë.

z. Fidaim Fazliu, Kryetari i BI Kacanik, Ne si BI i kemi marrë të gjitha rekomandimet e nevojshme të IKSHF, dhe po i zbatojmë. Si BI kemi marrë vendim për mos dalje të namazit në xhamia. Ne bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe në bashkëpunim me mekanizmat tjerë, po punojmë me e përballuar Covid-19.

znj. Kaltrina Tafili, Pas orës 16: 00 komandanti i policisë tha se po dalin shumë njerëzit më të madhe në qytet për nevoja të tyre. A keni marrë ndonjë hap në këtë drejtim, sepse kjo dalje masive mund të paraqet rrezik për përhapjen e Covid-19.

Komandanti i policisë, Lirinë e lëvizjes nuk mundemi të pengojmë pas orës 16:00, sepse është e lejuar me vendim të qeverisë së Kosovës. Për me u ndaluar kjo dalje masive e qytetarëve të komunës, duhet një vetëdijësim i qytetarëve të komunës.

z. Besim Vishi, Nga postimet të cilat i kemi parë në facebook lidhur me grumbullimin e qytetarëve të komunës për me marrë miell, në një market në f. Nikaj dhe në një market tjetër. A ka mundësia policia me marrë ndonjë veprim për me mbajtur një rregull e rend ne kohën kur ka furnizime me miell të shitoreve ushqimore.

Komandanti i policisë-Halim Shehu, Ne me pasur kërkesa se kur do të shpërndahe mielli, ne e monitorojmë atë lokacion.

znj. Nazife Krasniqi, A keni të dhëna për hyrje ilegale të qytetarëve që vijnë nga diaspora dhe a keni numër të saktë sa persona kanë hyrë në komunën tonë përmes kufirit. Kryetari i Komunës tha se kemi nesër mbledhje me administratorët e fshatrave dhe ata besoj se i kanë të dhënat. A kanë hyrë ne karantinë zyrtarët e komunës që janë kthyer nga diaspora, A ka kushte me u ndal ndonjë pacient me virus në QKMF apo gjithsesi duhet të dërgohet ne Prishtinë.

z. Bekim Koxha, I përshëndeti të gjitha ata që janë duke punuar për çështjen e koronavirusit. Covid nuk njihet njeri, kështu që duhet secili nga ne në pozitë që kemi të angazhohemi e t'i kryejmë punët tona. Në emër të subjektit politik NISMA, konfirmoj se e përkrahim ndarjen e mjeteve për menaxhimin e Covid-19.

z. Sinan Zeneli-Drejtor i QKMF, Lidhur me pyetjen e znj. Nazife Krasniqi, përgjigja është: testimi dhe hospitalizimi behën ne QKMF, pastaj pacientët dërgohen ne Prishtinë.

Kryetari i Komunës, Me herët kemi pasur 61 persona që janë kthyer, ndërkaq nga data kur është vendosur të hyjnë në karantinë, të gjithë të kthyerit do t'i nënshtrohen këtij procesi të karantimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë konstatoj me kaluar në rendin e punës. Për këtë takim kemi paraparë këtë:

REND PUNE

1. Për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19.

Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje do të punoj me këtë pikë. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunes-Besim Ilazi, Mjetet buxhetore janë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Fillimisht kemi menduar me i ndarë mjete buxhetore në shumë 100,000.00 euro, pastaj të shikojmë se çka mundemi me bërë në të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka ne këtë pikë e hapi diskutimin:

z.Nexhat Loku, Ne emër të GP të PDK, konfirmoj se e mbështetim ndarjen e mjeteve të propozuara për destinacionin e caktuar.

z. Ekrem Kyçyku, I përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, në veçanti, Komandantin e policisë, drejtorin e QKMF, Kryetarin e BI, ndërkaq kërkoj të respektohen

Udhëzimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me pandeminë. Ne emër të LVV konfirmoj së e mbështetim lejin e mjeteve buxhetore të propozuara për menaxhimin e pandemisë Covid -19.

z. Selim Reka, Është fat që nuk kemi në komunën tonë ende ndonjë të prekur nga virusi i përhapur C ovid-19. Në emër të GP të LDK e përkrahim lejin e mjeteve buxhetore për çështjen e koronavirusit,, kur dihet fakti së nuk ka asgjë vlerë sesa jeta e njeriut. Duhet pasur parasysh faktin se ka njerëz me gjendje të rëndë ekonomike të cilët nuk marrin as ndihma sociale, kështu që duhet pasur parasysh këto kategori në shpërndarjen e gjërave ushqimore.

Kryesuesi i Kuvendit, Shtabi i Emergjencës dhe Kryetari i Komunës kanë me shqyrtuar secilin rast që ka nevojë, kështu që do t'iu dilet në ndihmë të gjithëve.

z. Bekim Koxha, Ne subjekti politik i NISMA, e mbështetim miratimin e propozim vendimit për lejin e mjeteve buxhetore për destinimin e caktuar, ndërkaq të shikohet së ku duhet shpërndahen gjëra ushqimore e higjienike, kur dihet fakti së në këtë kohë, shumë firma private i kanë larguar nga puna punëtorët e tyre.

z. Ekrem Raka, Mbajtja e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme, po i shkelim Udhëzimet dhe vendimet në qeverisë së Republikës së Kosovës që janë në fuqi. Vendimi për ndarjen e 100 mijë janë shumë mjete, ndërkaq nuk ka orientime për shpërndarjen e tyre. Nuk është përcaktuar së nga do të merren këto mjete buxhetore dhe ku do të shpërndahen.

Kryesuesi i Kuvendit, Në konsultim me komandantin e policisë, nuk ka kufizim të lirisë së lëvizjes. Ne, për kundër pezullimit të aktiviteteve të KK, jemi mbledhur për një çështje shumë të rëndësishme, duke u marrë të gjitha veprimet paraprake për sigurimin e kushteve për mbajtje të mbledhjes.

z. Adnan Reka, Ne sot, nuk do te duhej të ishim në këtë seancë, për disa arsye;

- Sepse, po e rrezikojmë shëndetin personal dhe shëndetin publik.
- Sepse, jemi ne kundërshtim me rekomandimet e te gjitha institucioneve përgjegjëse si OBSH dhe IKSHPK
- Sepse, jemi ne kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Kosovës për lirinë e lëvizjes se qytetarëve në kohë të caktuar, si dhe Qarkoren e Qeverisë për pezullimin e të gjitha takimeve dhe tubimeve të çfarëdo lloji.
- Sepse, një fond të tillë për situata emergjente komuna jonë do të duhej ta kishte shumë më herët, atëherë kur ne i patëm rekomanduar një gjë të tillë, por që nuk e kanë përfillur.
- Sepse, Kuvendi nuk duhet të vihet ne lajthitje dhe të shfrytëzohet për të zhvendosur mjete nga kategoritë e ndryshme buxhetore, duke e shfrytëzuar situatën që jemi, por do të duhej të parashiheshin në situata normale.
- Dhe sepse, Komuna jonë nuk duhet të ndjekë gjithnjë shembujt jo të mirë të Komunave tjera.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë, Propozim Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 100,000.00€ (njëqind mijë euro) për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli i pyeti anëtarët e KK së a jeni të pajtimit që Shtabi Emergjent të plotësohet me tre anëtarët nga KK. Ky propozim u shtrua në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Atëherë shkojmë me propozime konkrete për 3 anëtarë nga tre subjektet politike me të mëdha.

z. Nexhat Loku, Nga subjekti politik i PDK e propozojmë z. Kadri Krivenjeva.

z. Ekrem Kycyku, Nga LVV e propozojmë, z. Agim Mani.

z. Selim Reka, Nga LDK e propozojmë z. Besnik Salihu.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi që Shtabi i Emergjencës i formuar nga Kryetari i Komunës të plotësohet edhe me 3 anëtarë nga Kuvendi i Komunës si vijon:

- 1.Kadri Krivanjeva, PDK,
- 2.Agim Mani, LVV , dhe
- 3.Besnik Salihu, LDK.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që mbledhja i përfundoj punimet në ora 10-53. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët të cilët ishin prezent në mbledhje.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Kemal Mërseli